



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 10450 Prot.

Roskovec, më 02.12 2022

VENDIM

NR 91 .DATË 01.12 .2022

“ PËR

MIRATIMIN PËR APLIKIM TË BASHKISË ROSKOVEC NË PARTNERITET ME SHOQËRINË E BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR “ROSKOVECI GREEN INVEST (RGI) PËR GRANTE NË FUSHËN E BUJQËSISË”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, neni 27, neni 28 neni 33 pika 1 gërmat “ç” dhe “d”, neni 54 , gërma “d”; Ligjit Nr.38/2012 “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”; ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” I ndryshuar, nenet 105-153; Vendimit nr.30 datë 19.04.2018 të Këshillit Bashkiak Roskovec për miratimin e dokumentit strategjik “*Studim mbi Zhvillimin e Bujqësisë në Bashkinë Roskovec*” miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr.612/1 prot.datë 30.04.2018, Vendimit të Këshillit të Bashkisë me nr. 84, datë 31.10.2022, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1.Miratimin për aplikim të Bashkisë Roskovec në partneritet me Shoqërinë e Bashkëpunimit Bujqësor “Roskoveci Green Invest (RGI)”, për të përfutuar grante për investime në asetet fizike për ndërtimin e pikës së grumbullimit, përpunimit dhe ambalazhimit të produkteve agrobujqësore (Pikë përpunimi të ndarë, ambalazhim dhe grumbullim të vajit të ullirit, përmes përdorimit të energjisë solare).

2.Miratimin e kontributit në natyrë për vendosjen e pasurisë konkretisht sipërfaqen prej 8970 (tetëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) m2 , nr. pasurie 213 , dhe zonë kadastrale 3805 kaluar në pronësi të bashkisë Roskovec sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë me nr. 84, datë 31.10.2022 (bashkëlidhur) si dhe planvendosjes për këtë sipërfaqe (bashkëlidhur), për ndërtimin e pikës së përpunimi të ndarë, ambalazhim dhe grumbullim të vajit të ullirit, përmes përdorimit të energjisë solare.

3. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për të firmosur marrëveshjen e partneritetit me Shoqërinë e Bashkëpunimit Bujqësor “Roskoveci Green Invest (RGI)”.

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

5.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

